



MARREVESHJE PENGU MBI KUOTAT

Ne Tirane, sot me 26.07.2016 (dy mije e gjashtembedhjete) ne zyren e Noterise Tirane,  
para meje Noterit B. Ferizaj, u paraqiten palet qe kerkuan redaktimin e kesaj Marreveshje  
Kalim Kredie ("Marreveshja") si me poshte:

a) Shoqeria bankare "BANKA SOCIETE GENERALE ALBANIA" SH.A., me seli ne adresen Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Twin Towers, Kulla 1, Kati i 9-te, Tirane, Shqiperi, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr. 30724 date 12.12.2003 te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, qe vepron si BANKE me Licensen Nr. 17 date 16.02.2004 te leshuar nga Banka e Shqiperise, me NIPT Nr. K41424801U, perfaquesuar nga Drejtori i Korporatave, Z. Ferid Shijaku, i biri i Sadiut, lindur ne Tirane, me 18.01.1968, banues ne adresen Rruga "Ali Demi", Pall. 148/1, Ap. 4, Tirane, mbajtes i Pasaportes Nr. BD9842102, dhe me nr. Personal G801181191, madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar, dhe nga Menaxhere Klientet Korporative, Zj. Atala Dedej, e bija e Hasanit, lindur ne Kavaje, me 11.10.1978, banuese ne adresen Rruga "Tefta Tashko", Pall. 120, Ap. 13, Tirane, mbajtese e Leternjoftimit Nr. 026075641, me nr. personal H86011026G, madhore, me zotesi te plete juridike per te vepruar (dhe ne vazhdim do te quhet "BANKA/PENGEMARRESI") nga njera ane; dhe

b) PENGEDHENESI: Shoqeria tregtare "EURON" SH.P.K. me seli ne adresen, Selite, Farke, Pallati Euron 7Kt, hyrja 1, njesia 1, Tirane, Shqiperi, regjistruar si person juridik shqiptar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me NIPT me Nr. Identifikimi J71317002N ne daten 08.03.1994, perfaquesuar ketu ne baze te Vendimit te Asamblese se Pergjithshme Nr. 22 date 16.07.2016 nga Ortaket e saj Z. Gezim Cela, i biri i \_\_\_\_\_, lindur ne \_\_\_\_\_, me \_\_\_\_\_, banues ne adresen Rruga "\_\_\_\_\_", Pall. \_\_\_, Shk. \_\_\_, Kati \_\_\_, Ap. \_\_\_, \_\_\_\_\_, mbajtes i Pasaportes/Leternjoftimit Nr. \_\_\_\_\_ leshuar ne daten \_\_\_\_\_, dhe nr. Personal 643031878 madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar; dhe Z. Kujtim Shpata, i biri i \_\_\_\_\_, lindur ne \_\_\_\_\_, me \_\_\_\_\_, banues ne adresen Rruga "\_\_\_\_\_", Pall. \_\_\_, Shk. \_\_\_, Kati \_\_\_, Ap. \_\_\_, \_\_\_\_\_, mbajtes i Pasaportes/Leternjoftimit Nr. \_\_\_\_\_ leshuar ne daten \_\_\_\_\_, dhe nr. Personal 687441864 madhor, me zotesi te plete juridike per te vepruar,

Banka dhe Kredimarresi "Euron Energy" Sh.p.k. / "Energal" Sh.p.k., do te referohen bashkerisht ne kete Marreveshje si "Palet" dhe veçmas si "Pala".

Meqenese:

- Palet kane lidhur nje Kontrate per Kredi Bankare Afatgjate Nr. 1128 Rep dhe Nr. Kol. 133 date 26.07.2016, te notere \_\_\_\_\_, ("Kontrata e Kredise"), sipas se ciles Banka i ka dhene kredi Kredimarresit "Euron Energy SH.p.k." ne shumen 7,900,000 EUR (shtate milion e nenteqind mije euro),

- Palet kane lidhur nje Kontrate per Kredi Bankare Afatgjate Nr. 12 Rep dhe Nr. Kol. 82 date 09.06.2006 te notere "Kontrata e Kredise", sipas se ciles Banka i ka dhehe kredi Kredimarresit "Energal SH.p.k." ne shumen 3,500,000 EUR (tre milione e peseqind mijë euro).
- TIRANE*
- Per te siguruar permbushjen e detyrimeve qe rrjedhin nga Kontratat e Kredive, Pengedhenesi i ka propozuar Banks t'i ofroje peng mbi Kuota ne masen e percaktuar me poshte, dhe Banka ka pranuar kete peng sipas kushteve dhe afateve percaktuar me poshte ne kete Marreveshje

Atehere, Palet lidhin kete Marreveshje dhe bien dakord per sa me poshte:

## 1 PERKUFIZIME, INTERPRETIMI USHTRIMI I TE DREJTAVE

### 1.1 Hyrja dhe shtojcat:

Hyrja dhe shtojcat e kesaj Marreveshje jane pjese perberese e saj, te detyrueshme per Palet dhe pasardhesit, çesionaret e tyre dhe perfituesit e transferimit.

### 1.2 Perkufizime:

Perveç nese percaktohet ndryshe ne kete Marreveshje, ose permbajtja e saj e kerkon ndryshe, shprehjet e perdonura ne Kontratat e Kredise do te kene te njejtin kuptim dhe ne kete Marreveshje. Gjithashtu, shprehjet e meposhtme do te kene kuptimin e meposhtem:

**"Marreveshje"** nenkupon kete marreveshje, ne baze te se ciles Pengedhenesi krijon ne favor te Pengmarresit peng te rradhes se pare mbi te gjitha Kuotat qe perfaqesojne kapitalin e nenshkruar dhe shlyer te Pengedhenesit.

**"Ligji i zbatueshem"** nenkupon dispozitat e Kodit Civil Shqiptar, konkretisht nenet 530-540 dhe nenet 546-559.

**"Pengedhenesi"** nenkupon **"EURON"** SH.P.K, nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e cila zoterohet nga Z. Kujtim Shpata ne masen 50 % pjesmarrje dhe nga Z. Gezim Cela ne masen 50% pjesmarrje.

Pengedhenesi eshte regjistruar prane Regjistrat Tregtar Shqiptar me nr. J71317002N dhe me seli ne adresen: Selite, Farke, Pallati Euron 7Kt, hyrja 1, njesia 1, Tirane, Shqiperi.

**"Kredimarresi"** nenkupon **"EURON ENERGY"** SH.P.K, nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise e cila zoterohet ne masen 100% pjesmarrje nga Shoqeria Euron

Sh.p.k.. nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e cila zoterohet nga Z. Kujtim Shpata ne masen 50 % pjesmarrje dhe nga Z.Gezim Cela ne masen 50% pjesmarrje. Kredimarresi eshte regjistruar prane Regjistrat Tregtar Shqiptar me nr. L57703202C dhe me seli ne adresen: Rruga Kukes, Shishtavec, Km.8, HC Bele 1, Zapod, Kukes, Shqiperi.

**"Kredimarresi"** nenkupton **"ENERGAL" SH.P.K.**, nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise e cila zoterohet zoterohet ne masen 88,68% nga Shoqeria Euron Sh.p.k.. nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e cila zoterohet nga Z. Kujtim Shpata ne masen 50 % pjesmarrje dhe nga Z.Gezim Cela ne masen 50% pjesmarrje dhe ne masen 11,32% pjesmarrje nga Shoqeria Kadria Sh.p.k. nje shoqeri e themeluar sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e cila zoterohet nga Z. Selim Kadria ne masen 100% pjesmarrje.

Kredimarresi eshte regjistruar prane Regjistrat Tregtar Shqiptar me nr. L57703201R dhe me seli ne adresen: Rruga Kukes-Orgjost, Km.10,HC Orgjost, Kukes, Shqiperi.

**"Dite Pune"** nenkupton nje dite ne te cilen bankat jane te hapura per kryerjen e veprimeve tregtare/bankare ne Tirane, Shqiperi.

**"Kolateral"** do te thote Kuotat dhe te Drejtat e Shperndarjes perkatese dhe te Drejtat e Nenshkrimit.

**"Kuotat"** nenkupton kuotat qe perfaqesojne 100% te kapitalit te nenshkruar te Pengdhenesit "EURON" SH.P.K.

**"Te Drejtat e Nenshkrimit"** nenkupton te gjitha te drejtat e Pengdhenesit per te nenshkruar dhe zotuer Kuotat per rastet jashte zmadhimit te kapitalit te Pengedhenesit.

**"Te Drejtat e Shperndarjes"** do te thote çdo pretendim per dividentet, shperndarjet, perfshire por pa u kufizuar ne pretendimet per shperndarjet si rrjedhim i zvogelimit te kapitalit themeltar, pretendimet nga te ardhurat prej likuidimit dhe pretendime per ripagimin e kontributit fillestar ne kapital, si dhe te gjitha pretendimet e tjera monetare lidhur me secilen nga Kuotat (siç eshte perkufizuar me poshte).

**"Rast Mosperm bushje"** nenkupton ndodhjen e nje Rasti Mosperm bushje ose Mosperm bushje e Mundeshme sipas percaktimit ne Kontratat e Kredive lidhur midis paleve.

**"Barre"** nenkupton çdo hipoteke, peng, barre, privilegj, prioritet, cedim, bashkim, kompensim ose garanci tjeter te çdo lloji, ose çdo marreveshje ose instrument tjeter qe ka per qellim dhenien e garancise nepermjet ose ne lidhje me, ose çdo veçim ose marreveshje privilegjuese ne lidhje me pasuri, te ardhura ose te drejta ekzistuese ose te ardhshme, perfshire percaktimin si perfittues ne policat e sigurimit ose ne çdo regjim tjeter te njashem.

"Peng" nenkupton garancine e krijuar ne baze te Nenit 2, me kusht qe shprehja "Peng" te perfshije çdo peng tjeter qe do te krijohet ne baze te ose ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje.

**"Detyrimet e Siguruara"** nenkupton:

- (i) te gjitha detyrimet monetare te tashme dhe te ardhme (perfshire Borxhet, Pergjegjesite and detyrimet te cilat jane te vleresueshme ne te holla), te Kredimarresit ose secilit Pengdhenes (ose çdo pale e nje Marreveshje Financimi e ndryshme nga Pengmarresi) ne çfaredo valute qofshin, per te cilat Pengdhenesi eshte apo mund te behet kohe pas kohe debitor ose perqejges kundrejt secilit Pengmarres sipas çdo Marreveshje Financimi, siç mund te ndryshohen kohe pas kohe.
- (ii) te gjitha detyrimet monetare per te cilat Kredimarresi ose çdo Pengdhenes (ose çdo pale e nje Marreveshje Financimi e ndryshme nga Pengmarresi) eshte apo mund te behet kohe pas kohe perqejges kundrejt ndonjerit nga Pengmarresit si rrjedhoje e drejtperdrejte apo e terthorte e Marreveshjeve te Financimit, siç mund te ndryshohen kohe pas kohe.
- (iii) te gjitha detyrimet monetare te tashme ose te ardhme te pagueshme ose te kerkueshme per tu paguar nga Kredimarresi ose çdo Pengdhenes (ose çdo pale e nje Marreveshje Financimi e ndryshme nga Pengmarresi) si pasoje e pagimit te shumave te percaktuara ne paragrafet (i), (ii) me siper te ruajtura ose revokuara ose te bera te paefektshme; dhe
- (iv) te gjitha detyrimet e Pengdhenesit sipas kesaj Marreveshje.

"Periudhe Garancie" nenkupton periudhen duke filluar nga data e kesaj Marreveshje deri ne daten ne te cilen te gjitha Detyrimet e Siguruara do te jene shlyer dhe paguar ne menyre perfundimtare dhe te pakushtezuar.

### 1.3 Interpretimi

1.3.1 Perveç kur konteksti e kerkon ndryshe, ne kete Marreveshje (si dhe çdo dokument tjeter qe ka lidhje me kete Marreveshje) termat ne vijim e te perdorura ne kete dokument do kete kuptimin e me poshtem:

- (i) "**pale**" do ti referohet sipas rastit Pengdhenesit ose Pengmarresit;
- (ii) "**rregullore**" perfshin çdo rregullore, rregull, udhezim zyrtar, kerkese ose direktive (e cila ka ose jo forcen e ligjit) i leshuar nga çdo organ shteteror, agjenci, departament ose ent rregulator, vete-rregulator, organ tjeter apo organizate;

- (iii) "person" perfshin çdo person fizik ose juridik shqiptar ose te huaj, ortakeri, autoritet publik ose shoqeri te thjeshte, si dhe perfshin pasardhesit dhe cesonaret e lejuar ose perfituesit e transferimit e secilit prej ketyre;
- (iv) çdo Nen ose paragraf eshte, perveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe ne kete Marreveshje, reference per Nene, paragafe te kesaj Marreveshje;
- (v) kjo Marreveshje ose çdo dokument tjeter, kontrate ose marreveshje, nenkupton nje reference ne kete Marreveshje ose dokument tjeter, kontrate ose marreveshje te ndryshuar kohe pas kohe;
- (vi) çdo ligj i Republikes se Shqiperise, vendim, dekret ose dispozite urdheruese perfshin ligjet, vendimet, dekreteret ose dispozitat urdheruese sic mund te ndryshohen kohe pas kohe , perfshire dhe legjislacionin sekondar (perfshire, por pa u kufizuar vetem ne to, udhezime ose vendime te ministrive ose çdo autoriteti tjeter kompetent) te nxjerre ne zbatim te ligjit, vendimit, dekretit ose dispozite tjeter urdheruese; dhe
- (vii) "Palet" i referohet se bashku Penghenesit dhe Pengmarresit.

1.3.2 Ne rastet kur nga permbajtja kerkohet perdorimi i fjaleve ne njeje perfshihet gjithashtu edhe shumesi dhe anasjelltas, dhe kur perdoren fjale qe i referohen nje gjinnie perfshihen te gjitha gjinite. Referanca ndaj Penghenesave perfshin çdo person te treguar ne kete perkufizim. Detyrimet e personave perfshire ketu dhe Penghenesit jane solidare dhe te ndara.

1.3.3 Titujt ne kete Marreveshje jane perdorur vetem per reference.

1.3.4 Ne rast te nje konflikti ndermjet dispozitave te kesaj Marreveshje dhe nje Shtojce te saj, dispozitat e kesaj Marreveshje do te mbizoterojne mbi Shtojcen.

#### 1.4 Ushtrimi i te drejtave

Te drejtat e Pengmarresit qe rrjedhin ne baze te, apo ne lidhje me, kete Marreveshje do te ushtrohen bashkerisht.

### **1.5 Krijimi i Pengut mbi Kuotat**

Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje, Pengdhenesi ne menyre te parevokueshme krijojne nje peng te rrades se pare mbi çdo te drejte, titull dhe interes te tyre mbi te gjitha Kuotat qe perfaqesojne 100% te kapitalit te nenshkuar te Pendhenesit, te Drejtat e Shperndarjes dhe te Drejtat e Nenshkrimit, ne favor te Pengmarresit, si garanci per shlyerjen e pote dhe te pakushtezuar te Detyrimeve te Siguruara.

### **1.6 Caktimi i perfaqesuesit te ekzekutimit**

Secili nga Pengmarresit sipas diskrecionit te tij mund te caktojne njeri tjetrit si perfaqesues te vet me te drejta ekskluzive per ekzekutimin e Pengut objekt i kesaj Marreveshje.

## **2 REGJISTRIMI I PENGUT MBI KUOTAT**

- 2.1 Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje, Pengdhenesi, ne menyre te parevokueshme dhe te pakushtezuar, pranon qe Pengmarresi, ne baze te kesaj Marreveshje, pa kerkesa dhe miratime te metjeshme, merr peng mbi Kuotat e Pengdhenesit si dhe merr persiper te njoftoje Kredimarresin ne lidhje me pengun mbi kuotat ne favor te Pengmarresit. Po ashtu brenda 3 Diteve Pune nga njoftimi, Pengdhenesi do te regjistroje (ne nje menyre te pranueshme nga Pengmarresi) pengun e dhene sipas kesaj Marreveshje ne (i) Regjistrin e Ortakeve/Kuotave te Pengedhenesit dhe (ii) Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombetare e Regjistrimit (Regjistri).
- 2.2 Me kryerjen e veprimeve siç tregohet, me siper, administratori i Kredimarresit do te leshoje per Pengmarresin nje deklarate ne formen dhe permbajtjen e pranueshme nga keto te fundit, ne lidhje me kryerjen e regjistrimit te pengut ne Regjistrin e Ortakeve/ Kuotave te Pengedhenesit.
- 2.3 Palet ne kete Marreveshje bien dakord qe te gjitha shpenzimet e regjistrimit te pengut do te perballohen nga Pengdhenesi.

## **3 RASTI I MOSPERMBUSHJES**

### **3.1 Ekzekutimi i Pengut**

- 3.1.1 Me ndodhjen e nje Rasti Mospermbushje dhe ne çdo kohe pas kesaj, Palet bien dakort qe Pengmarresi, perveç te drejtave qe i takojne sipas kesaj Marreveshje ose Ligjit, kane te drejten per te deklaruar menjehere te kerkueshme dhe te ekzekutueshme te gjitha Detyrimet e Siguruara sipas kesaj Marreveshje, te drejten te mbledhin me shpenzime te arsyeshme te gjithe detyrimin, perfshire shpenzimet gjyquesore, tarifat e avokatit dhe shpenzime te tjera ligjore, si dhe te gjitha te drejtat e tjera qe i perkasin Pengmarresit sipas ligjit.

Penghenesi pranon se kjo eshte Marreveshja e Pengut sipas dispozitave te Ligjt te Zbatueshem.

- 3.1.2 Penghenesi jep shprehimisht pelqimin qe me dhenien e nje Njoftimi te nje Rasti Mospermbushje dhe çdo kohe pasi i eshte dhene ky Njoftim, Pengmarresi do te kete te drejte te mbledhe dhe te marre nga Kredimarresi, - pa urdher ekzekutimi, vendim gjykate ose çdo vendim tjeter gjyqesor - pagesa per dividende, te tjera te Drejta te Shperndarjes dhe çdo shume tjeter te paguar ose te pagueshme ne lidhje me Kuotat duke i derguar nje njoftim Kredimarresit, ku deklarohet se nje Njoftimi i Rastit te Mospermbushjes i eshte dhene dhe se pagesat per dividendet, te Drejtat e Shpendarjes dhe çdo shume tjeter te paguar ose te pagueshme ne lidhje me Kuotat e Penghenesit i duhen bere Pengmarresit. Nje kopje e ketij njoftimi do t'i jepet Penghenesit. Nga data e marrjes se nje kopje te njoftimit te siperpermendur nga Penghenesi, Penghenesi do te siguroje qe Kredimarresi te mos kryeje asnje pagese per dividendete, te Drejta Shperndarjes dhe çdo shume te paguar ose te pagueshme ne lidhje me secilen nga Kuotat.

#### 4 PERDORIMI I TE ARDHURAVE

Te ardhurat nga ekzekutimi i Pengut duhet t'i paguhen Pengmarresit. Çdo e ardhur nga ekzekutimi ose shuma te tjera te perfitura nga Pengmarresi pertej shumes se Detyrimeve te Siguruara duhet t'i kalohet Penghenesit.

#### 5 TE DREJTAT E SHPERNDARJES

##### 5.1 Deri ne momentin qe eshte dhene Njoftimi i Rastit te Mospermbushjes

Deri ne momentin kur eshte derguar Njoftimi i Rastit te Mospermbushje, Penghenesi, pavaresisht vlefshmerise se pengut te krijuar, ne perputhje me kushtet e Kontrates se Kredise do te kete te drejte te ushtroje te gjitha te Drejta e Shperndarjes.

##### 5.2 Pas dhenies se Njoftimit per Rastin e Mospermbushjes

- 5.2.1 Me dergimin e nje Njoftimi per Rast Mospermbushje, Penghenesi nuk ka me te drejte te perfitoje secilen nga te Drejta e Shperndarjes dhe ne menyre te pakthyeshme Penghenesit me dergimin e Njoftimit te Rastit te Mospermbushjes autorizon dhe i jep te drejten Pengmarresit te udhezoje anetaret e bordit drejties/administratorin e/te Kredimarresit, te mos disponoje pa miratimin paraprak me shkrim te Pengmarresit çdo te Drejta te Shperndarjes.
- 5.2.2 Nese nje Njoftim Rasti Mospermbushje eshte derguar, te gjithe dividendet, pagesat ne lidhje me te Drejta e Shperndarjes dhe çdo shume e paguar ose e pagueshme

ne lidhje me Kuotat do t'i dorezohen menjehere Pengmarresit, ose nese eshte marre nga Pengdhenesi, do te merren dhe mbahen nga Pengdhenesi per llogari te Pengmarresit, do te veçohen nga asetet e tjera, pasurite e Pengdhenesit dhe menjehere do t'i paguhen dhe/ose dorezohen (sipas rastit) Pengmarresit (te pajisura me çdo miratim) per t'u mbajtur si garanci per Detyrimet e Siguruara.

- 5.2.3 Ne rast mospermbushje te Kredimarresit sipas kontratave perkatese te kredise ose te kesaj Marreveshje, Pengdhenesi autorizon shprehimisht dhe ne menyre te parevokueshme Pengmarresin qe, pa patur nevoje per miratim apo njoftim, te paguajne ne rruge jashtegjyqesore detyrimet, interesat dhe te gjitha shpenzimet, qofshin gjyqesore ose jo, ne perputhje me Ligjin, duke i mbajtur nga fondet e krijuara nga shitja e Kuotave. Pengdhenesi miraton dhe autorizon shprehimisht ne menyre te parevokueshme Pengamarresin te ndermarre te gjitha veprimet ne lidhje me ripagimin ne rruge jashtegjyqesore.

## 6 TE DREJTAT E VOTES

- 6.1 Pengdhenesi, pavaresisht pengut te kriuar, do te kete te drejten te ushtroje te gjitha te drejtat e votes lidhur me Kuotat ne perputhje me kushtet e treguara ne kete Marreveshje dhe ne çdo marreveshje tjeter te lidhur midis Pengdhenesit dhe Pengmarresit. Gjithsesi, palet bien dakord qe Pengmarresi mund te ushtroje te drejtat e votes qe i bashkelidhen Kuotave, ne rast se Pengmarresi zgjedh ta beje kete.
- 6.2 Pergjate Periudhes se Garancise, te drejat e votes do te ushtrohen nga Pengdhenesi ne ate menyre me qellim qe te mos miratohet asnje vendim i cili (i) mund te jete ne kundershtim me kete Marreveshje, (ii) mund te cenoje vlefshmerine ose ekzekutimin e secilit peng, (iii) mund te jete ne kundershtim me dispozitat e Kontratave te Kredive (iv) mund te cenoje te drejtat e Pengmarresit qe rrjedhin nga ose lidhen me kete Marreveshje.

Ne veçanti, Pengdhenesi nuk do te marre asnje vendim ose veprime tjera per llogari te Kredimarresit me qellim likuidimin, zvogelimin e kapitalit themtar, bashkim, perthithjen, ndarjen, shnderrimin, transformimin, ose çdo ristrukturim tjeter te Kredimarresit pa miratimin paraprak me shkrim te Pengmarresit.

## 7 PERFUNDIMI I TE DREJTAVE TE PENGMARRESIT

Me perfundimin e Periudhes se Garancise, Pengu i kijuar sipas kesaj Marreveshje do te perfundoje dhe te gjitha te drejtat e tjera mbi Kolateralin do t'i rikthehen Pengdhenesit. Me perfundimin e Periudhes se Garancise, Pengdhenesi, me shpenzimet e Pengmarresit, do te ekzekutoje dhe do t'i dergojne Pengmarresit dokumentet te cilat mund t'i kerkojne ne menyre te arsyeshme Pengmarresit, per te provuar perfundimin.

## 8 DEKLARIME DHE GARANCI

### 8.1 Deklarime dhe Garanci te Pengdhenesit

Pengdhenesi dhe Kredimarresi deklarojne se ekstraktet nga Regjistri i Ortakeve te Kredimarresit, te cilat jane pjese e kesaj Marreveshje, reflektuese putesisht dhe saktesisht statusin aktual dhe ligjor te Kuotave ne lidhje me pronesine, si dhe se nuk ekzistojne te drejta te te treteve (perfshi Barre mbi Kuota), te cilat mund te kufizojne apo zvogelojne pronesine e Pengdhenesin mbi Kuotat dhe te drejtat e pronesise ne lidhje me to.

Pa cenuar dhe ne vijim te deklarimeve dhe garancive te percaktuara ne Kontratat e Kredive, Pengdhenesi deklaron dhe garanton, si dhe do te deklaroje dhe garantoje per gjate kohezgjatjes se Periudhes se Garancise, Pengmarresit per sa me poshte vijon:

- (a) Nuk ka asnje Barre mbi Kuotat, perveç Pengut dhe interesave te tjera te pasurore te krijuara sipas kesaj Marreveshje.
- (b) Pengu:
  - (i) eshte dhene dhe krijuar rregullisht nga Pengdhenesi dhe te gjitha detyrimet ne kete Marreveshje perbejne detyrime te vlefshme dhe te detyrueshme per Pengdhenesin, si dhe jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar; dhe
  - (ii) dhenia, krijimi, dhe kompletimi i Pengut dhe dispozitat e kesaj Marreveshje nuk bien ne kundershtim me ndonje Ligj, vendim gjykate apo autoriteti publik, ose me dokumentet themeluese te Pengdhenesit;
- (c) perveç garancive te krijuara sipas kesaj Marreveshje, Pengdhenesi garanton se zoteron titull te plete pronesie mbi Kuotat, te lire nga çdo Peng, barre, ose e drejte e paleve te treta, dhe se Kuotat nuk do te jene objekt i ndonje sekuestrimi, barre ose te drejte te paleve te treta;
- (d) asnje kerkese ose padi nuk eshte paraqitur ose, ne dijeni te tyre, pritet te paraqitet perpara gjykatave ose arbitrazhit, ne Republiken e Shqiperise ose jashtë saj, ne lidhje me Kuotat;
- (e) interesat pasurore mbi Kuotat dhe dispozitat e kesaj Marreveshje nuk bien ne kundershtim me ndonje marreveshje ose sipermarrje tjeter ne te cilin

Penghenesi eshte pale, me dispozitat e Ligjit ose me aktet e shoqerise te cilat jane te detyrueshme per Penghenesin;

- (f) "shoqeria **"EURON"** SH.P.K.", eshte "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar", rregullisht te themeluara dhe qe ushtrojne aktivitetin e tyre ne perputhje me legjislacionin e Republikes Shqiperise dhe nuk jane subjekt i ndonje procedure falimentimi, likuidimi ne Republiken e Shqiperise ose ne ndonje juridikSION tjeter;
- (g) "shoqeria **"EURON"** SH.P.K.", nuk eshte ne paaftesi paguese ose subjekt i procedurave te prishjes, likuidimit, falimentimit; ka status aktiv.

## 9 ANGAZHIMET E PENGDHENESIT

### 9.1 Angazhimet te Penghenesit

Deri ne momentin kur Penghenesi do te marre njoftimin me shkrim nga Pengmarresi se Periudha e Garancise ka perfunduar, ose kur Pengmarresi bie dakord ndryshe, Penghenesi merr persiper sa me poshte vijon:

- (a) nuk do te ndermarre asnjë veprim:
  - (i) i cili mund te cenoje, ne menyre direkte ose indirekte vlefshmerine, efektivitetin ose ekzekutimin e Pengut, ose te te drejtave dhe interesave te Pengmarresit sipas Kontratave te Kredive ose çdo Marreveshje Financimi tjeter;
  - (ii) i cili mund te cenoje vlefshmerine apo ekzistencen e Kontratave te Kredive ose çdo Marreveshje Financimi tjeter ose te drejtave te Pengmarresit qe rrjedhin nga keto;
- (b) te kryeje me shpenzimet e tyre, te gjitha veprimet te cilat jane te nevojshme ose te arsyeshme, per sigurimin e vlefshmerise, efektivitetit dhe ekzekutimin e Pengut ose te te drejtave te Pengmarresit, perfshire dhe pretendimet e te treteve;
- (c) te nenshkruej me menjehere me shpenzimet e tyre dhe te paraqese te gjithe dokumentet, si dhe te ndermarre te gjitha veprimet e nevojshme me qellim:
  - (i) kryerjen e regjistrimit, kompletimit te Pengut; dhe
  - (ii) t'i mundesoje/siguroje Pengmarresit ushtrimin e te drejtave qe i perkasin sipas kesaj Marreveshje, perfshire, por pa u kufizuar vetem ne to, te gjitha te drejtat ne rast te ndodhjes se nje Rasti Mospermbushje;

- (d) te mos krijoje ose lejoje krijimin e ndonje Barre, pengu, interesi pasuror, barre tjeter te paleve te treta mbi te gjithe ose pjese te aseteve ekzistuese dhe te ardhshme te Pengdhenesit, perfshire Kuotat, perveç Pengut dhe garancive te krijuara sipas Marreveshjeve te Financimit perkatese;
- (e) te demshperbleje Pengmarresin ne lidhje me çdo pretendim apo padi e ngritur dhe/ose e paraqitur nga te tretet ne lidhje me Penguin;
- (f) te nenshkruaje, pranoje dhe kryeje transferimet, cedimet dhe dokumentet e metejshme, qe mund te kerkohen ne menyre te arsyeshme nga Pengmarresi ne menyre qe kjo Marreveshje te kete efekt, si dhe te paguaje te gjitha shpenzimet per kerkimet, regjistrimet dhe depozitimet;
- (g) te ~~rimbursoje~~ Pengmarresin per çdo shpenzim, perfshire tarifat ligjore qe keto te fundit kane kryer ne lidhje me ekzekutimin e kesaj Marreveshje;
- (h) do te njoftojne menjehere Pengmarresin per çdo ndryshim ne emertimin e Pengdhenesit;
- (i) t'i dorezoje menjehere Pengmarresit te gjitha njoftimet dhe dokumentet e tjera te marra ne lidhje me Kuotat, perfshire, por pa u kufizuar, dhe pretendimet e paleve te treta;
- (k) te pajisin menjehere Pengmarresin me te gjithe informacionin lidhur me Penguin.

## 10 DEMSHPERBLIMI, TAKSAT, KOSTOT DHE SHPENZIMET

### 10.1 Pergjegjesia e Pengmarresit

Pengmarresi nuk eshte pergjegjes, me perjashtim te rastit te pakujdesise se rende dhe fajit nga ana e tyre, per demet e shkaktuar Pengdhenesit si pasoje e ushtrimit ose mosushtimit te te drejtave qe ato kane sipas kesaj Marreveshje, rast ne te cilin pergjegjesia e Pengmarresit do te jete e ndare.

### 10.2 Demshperblimi

Pengdhenesi, me kerkese te Pengmarresit, do te rimbursoje keto te fundit per çdo takse, pulle takse, shpenzim dhe tarife (perfshire tarifat ligjore dhe notoriale) qe Pengmarresi ka kryer ne lidhje me:

- (i) krijimin ose ekzekutimin e Pengut; dhe

(ii) çdo mospermbushje te Pengdhenesit ne lidhje me kete Marreveshje.

## 11 NJOTIMET

### 11.1 Adresat

Te gjitha njoftimet ne lidhje me kete Marreveshje do te kryhen ne adresat e treguara me poshte:

**Nese i drejtohen Pengmarresit:**

- “Banka Societe Generale Albania” ShA.  
Bulevardi Deshmoret e Kombit  
Twin Towers, Kulla 1,kati i 9,  
Tirane, Shqiperi  
Ne vemandje te: Zj. Atala Dedej

**Nese i drejtohen Pengdhenesit:**

-“EURON” SH.P.K.

Adresa: Selite, Farke, Pallati Euron 7Kt, hyrja 1, njesia 1, Tirane, Shqiperi

### 11.2 Ndryshimi i Adreses

Secila pale mund t'i komunikoje pales tjeter me poste te regjistruar nje adrese te ndryshme per te kryer te gjitha njoftimet.

### 11.3 Forma e Njoftimit

Te gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera sipas ose ne lidhje me kete Marreveshje do te jepen me shkrim dhe, perveç kur parashikohet ndryshe ose kerkohet nga Ligji, mund te behen me faks. Te gjitha keto njoftime do te quhet te dhena kur faksi eshte marre nga marresi, me kusht qe nje njoftim i marre jo ne nje Dite Pune te quhet i dhene ne Diten e Punes pasardhese. Pavaresisht nga sa me siper, çdo njoftim i nje Rasti Mospermbushje do te kryhet me poste te regjistruar dhe quhet i dhene me marrjen e tij.

## 12 DISPOZITA TE NDRYSHME

### 12.1 Ndryshimet dhe Heqja Dore

Asnje ndryshim ose heqje dore nga dispozitat e kesaj Marreveshje nuk do te jete e vlefshme perveç kur behet me miratimin me shkrim te Pengdhenesit dhe Pengmarresit. Pengmarresi mund

te jape zjatje afati dhe lehtesira te tjera, kompromise, zgjidhje, çlroje dhe shkarkoje ose te hyje ne çdo menyre tjeter ne marreveshje me Pengdhenesin, ne lidhje me Kuotat sipas gjykimit te arsyeshem te Pengmarresit, pa cenuar perjegjesine e Pengdhenesit dhe te drejtat dhe detyrimet e Pengmarresit sipas kesaj Marreveshje ose Ligjit.

## 12.2 Ndryshimi, Cedimi, Zevendesimi

Kjo Marreveshje eshte e detyrueshme per Pengdhenesin, pasardhesit e tyre, perfituesit dhe cessionaret edhe me ndyshimin, cedimin ose zevendesimin e Kontratave te Kredive ose çdo Marreveshje Financimi tjeter dhe Pengdhenesi pranon shprehimisht vazhdimin e Pengut ne rast te zevendesimit teresisht ose pjeserisht te Detyrimeve te Siguruara, si dhe merr persiper, nese kerkohet nga Pengmarresi, te jape me shkrim miratimin e tyre per kete vazhdim, ne daten e ndyshimit ose ne nje date te meparshme, per çdo ndryshim, cedim ose zevendesim te Marreveshjes se Financimit perkatese ose transferim ose cedim te Detyrimeve te Siguruara.

## 12.3 Interesi i Vazhdueshem

Pengu i krijuar sipas kesaj Marreveshje do te jete i detyrueshem per Pengdhenesin, pasardhesit dhe cessionaret e tyre dhe do te mbetet plotesisht ne fuqi, si dhe do te perbeje dhe do te jete nje garanci e vazhdueshme pavaresisht pageses ose perm bushjes se pjesshme te Detyrimeve te Siguruara, si dhe nuk do te cenohet ose preket kurrsesi nga ndonje barre tjeter, demshperblim ose garanci e dhene nga Pengdhenesi ne favor te ndonje pale te trete ose nga ndonje vendim gjykate apo urdher i marre nga Pengmarresi ne lidhje me Detyrimet e Siguruara.

## 12.4 Transferimi

Pengdhenesi nuk do te transferoje apo kaloje, teresisht ose pjeserisht, te drejtat e tij sipas kesaj Marreveshje pa miratimin paraprak me shkrim te Pengmarresit.

## 12.5 Instrumentet e tjera mbrojtese

Te gjitha te drejtat, veprimet dhe perfshire veprimet mbrojtese te Pengmarresit sipas kesaj Marreveshje nuk perjashtojne çdo te drejte apo veprim tjeter qe Pengmarresi mund te ushtroje sipas kontrates (perfshire, por pa u kufizuar, Kontratat e Kredise) ose sipas Ligjit te Zbatueshem.

## 12.6 Taksat dhe Shpenzimet

Te gjitha detyrimet, taksat dhe shpenzimet e tjera zyrtare perfshire, por pa u kufizuar ne, taksa pulle, tarifat per regjistrimin gjyqesor, tarifa notieriale, shpenzime, pagesa dhe detyrime te tjera qe mund te maturohen dhe te behen te pagueshme ne lidhje me perfundimin, regjistrimin, nenshkrimin, kompletimin dhe ekzekutimin e kesaj Marreveshje do te perballohen nga

Penghenesi. Nese keto shpenzime jane kryer nga Pengmarresi, Penghenesi do te kompensoje/rimbursoje Pengmarresin per keto detyrime menjehere pasi te kete marre nga Pengmarresi kerkesen perkatese te shoqeruar nga fature ose dokument tjeter qe provon ne menyre te arsyeshme pagesen e kryer nga Pengmarresi.

### 12.7 Veçueshmeria e Interesave Pasurore

Palet ne kete Marreveshje bien dakord dhe pranojne shprehimisht se Penguin mbi Kuotat perben nje garanci ne favor te Pengmarresit, e veçuar nga çdo garanci tjeter qe eshte dhene ose do te jepet nga Penghenesi ose çdo ortak i Penghenesit ose Kredimarresi ne favor te Pengmarresit per sigurimin e permbushjes se Detyrimeve te Siguruara. Palet bien dakord qe Pengmarresit mund te ushtroje te drejtat e tyre sipas kesaj Marreveshje, pavaresisht nga te drejtat e tyre sipas ndonje garancie tjeter e cila siguron permbushjen e Detyrimeve te Siguruara.

### 12.8 Veçueshmeria

Dispozitat e çdo Neni ose paragrafi te kesaj Marreveshje jane te ekzekutueshme ne menyre te pavarur dhe vlefshmeria e tyre nuk do te cenohet nese ndonjera prej tyre do te jete e pavlefshme. Nese nje dispozite eshte e pavlefshme por do te jete e vlefshme nese nje pjese e dispozites do te fshihet, dispozita ne fiale do te zbatohet me kete ndryshim sipas rastit per ta bere ate te vlefshme.

### 13. Ligji Zbatueshem dhe Jurisdikzioni

Kjo Marreveshje lidhet dhe do te konsiderohet per efekt interpretimi dhe ekzekutimi si pjese perberese e Kontratave te Kredive.

Çdo kusht apo formulim qe mund te sjelle paqartesi do te interpretohet ne kontekstin e teresise se Marreveshjes dhe Kontratave te Kredive, si dhe shtesave apo ndryshimeve te saj dhe ne kendveshtrimin e qellimit qe i shtyu Palet te lidhin kete Marreveshje.

### 14. Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

Palet do te mundohen te zgjidhin mosmarreveshjet e tyre me mirekuptim ne te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

### 15. Te Ndryshme

Kjo Marreveshje hartohet ne gjuhen shqipe dhe nenshkuhet ne kater kopje me vlere te njeje ligjore.

Çdo ndryshim i kesaj Marreveshjeje do te jete i vlefshem ne rast se hartohet me shkrim dhe nenshkruhet nga te dy Palet.

Ne rast se ndonje Nen i kesaj Marreveshjeje, e cila mund te ndryshohet sipas rastit, shpallet i pavlefshem ose i anullueshem, pjeserisht ose teresisht, nga nje gjykate me juridikSION kompetent, pjesa tjeter e Marreveshes vazhdon te kete fuqi dhe efekt te plote.

Une Noteri, pasi ua lexova kete Marreveshje me ze te larte Paleve, i bindur qe permbajtja e kesaj Marreveshje eshte ne perputhje me vullnetin e tyre te lire, e hartoj kete Marreveshje ne 4 (kater) kopje ne gjuhen Shqipe dhe vertetoj nenshkrimet e tyre ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem.

#### PALET KONTRAKTUESE:

BANKA  
“BANKA SOCIETE GENERALE  
ALBANIA” SH.A.  
perfaqesuar nga:

Drejtori i Korporatave  
Z. Ferid Shijaku

Menaxhere Klientet Korporative  
Zj. Atala Dedej

#### PENGEDHENESI

Shoqeria tregtare  
“EURON”SH.P.K

Perfaqesuar nga:

Ortaket e saj  
Z. Gezim Cela

Z. Kujtim Shpata

Atala Dedej

